

Udhëzime për aplikim

- Aplikimi për zyrtarë policor bëhet në formë fizike.
- Aplikacionit për punësim i bashkëngjitet dokumentacioni i kërkuar sipas konkursit.
- Në formularin e aplikimit duhet të shënoni informacione të sakta lidhur me të dhënat e kërkuara.
- Nëse të dhënat e prezantuara në aplikacion vërtetohen se janë të pasakta do të rezultojë me largimin tuaj nga konkurrimi.

Pyetjet e shtruara më shpesh

ÇFARË DUHET TË DINI?

Në çdo fazë të procesit do t'i keni instruksionet me shkrim lidhur me procesin e seleksionimit. Në çdo fazë të testimit do të informoheni me kohë për rezultatin e arritur, përmes faqes zyrtare të PK-së në adresën e cekur më lart.

ÇFARË NDODH NËSE DËSHTOJ NË NJË FAZË (PJESË) TË TESTIMIT?

Nëse kandidati dështon në njërin nga fazat e testimit ai/ajo nuk ka të drejtë të vazhdojë me fazat tjera dhe nuk i lejohet përsëritja e testit. Në këtë rast kandidati e ka mundësinë e aplikimit në konkurset e ardhshme të regrutimit për zyrtar policor.

CILI ËSHTË QËLLIMI I REKRUTIMIT TË STAFIT NË PK?

Policia e Kosovës ka për qëllim të përgatis zyrtarë policorë të arsimuar që të jenë në gjendje të gjykojnë drejt, të komunikojnë qartë, të marrin vendime, të udhëheqin dhe të përballen suksesshëm me sfidat e së ardhmes.



**Aplikacioni i juaj është i rëndësishëm
Lexoni me kujdes UDHËZIMET**



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme/ Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/ Policija Kosova/ Kosovo Police

PROCEDURA E APLIKIMIT

Informata të nevojshme për procesin
e aplikimit për punësim në Policinë e Kosovës



Ndërtesa, administrata e policisë
Tel: 038/5080, local 1002 dhe 038/245 184

Çfarë duhet të dini?

Procesi i aplikimit për Policinë e Kosovës si rekrut i Policisë është i ndryshëm nga çdo proces tjetër i aplikimit. Ju do ta filloni procesin duke u siguruar se i plotësoni të gjitha kushtet minimale që janë caktuar për aplikantin për zyrtar policor.

KUSHTET MINIMALE PËR APLIKIM:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Ta ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë veprë penale;
- Të mos posedojë tatuazh në pjesë të dukshme të trupit;
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim Online:

- a) Diploma për arsimin e mesëm të lart ,ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit diploma e nostrifikuar;
- b) Certifikata e Gjendjes Penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- c) Një fotografi të formatit (5 x 5);

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim në mënyrën fizike:

- a) Diploma për arsimin e mesëm të lart ,ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit diploma e nostrifikuar;
- b) Certifikatën e lindjes/ekstrakti i lindjes;
- c) Certifikata e Gjendjes Penale;
- d) Kopje e leternjoftimit apo Pasaportes;
- e) Një fotografi të formatit (5 x 5);
- f) Dokumenti nga pika **b)** dhe **c)** të jetë i vlefshëm (jo me i vjetër se 6 muaj);

Faza e parë - testi me shkrim

Nëse aplikacioni juaj është i kompletuar dhe dokumentet e nevojshme janë të bashkëngjitura, ju do të ftoheni të merrni pjesë në testin me shkrim. Provimi do të përbëhet nga 100 pyetje dhe është i dizajnuar të vlerësojë kandidatin në fushën e njohurive të përgjithshme, matematikë dhe gramatikë. Kjo gjithashtu do të na mundësojë që të përcaktojmë nëse ju keni aftësi të përgjithshme për t'u bërë polic. Ju duhet t'i arrini 70% të pikave të përgjigjeve të sakta në këtë provim.



Faza e dytë -testi i shkathtësive fizike

Nëse me sukses e kryeni testin me shkrim, përmes listave të publikuara do të njoftoheni për t'u paraqitur në testin e aftësive fizike. Nga broshura “Procedura e testimit të aftësive fizike” ju do të njoftoheni për informata se çfarë do të kërkohet nga ju gjatë fazës së testimit. Nëse nuk do të arrini në vendin e testimit në kohën e caktuar, ju nuk do të mundeni t'i nënshtroheni testimit.

Faza e tretë - intervista

Pas kryerjes me sukses të provimit me shkrim dhe testit të aftësive fizike atëherë ju do të vazhdoni me fazën e tretë që është intervista . Ju do të njoftoheni me kohë për datën kohën dhe vendin se ku do të mbahet intervista.

Qëllimi i intervistës është të vlerësojë:

- a.Pjesën për testimin e personalitetit (paraqitja, qëndrimi etj),
- b. Pjesën për testimin e aftësive komunikuese,
- c. Pjesën për testimin e njohurive të përgjithshme (njohuritë themelore për organizimin institucional dhe shtetëror, ekonomik),
- d.Pjesën për testimin e njohurive që lidhen me vendin e punës-profesionin e policit (vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për t'u bërë polic, aftësisë për të menduar dhe analizuar, sjelljes korrekte me rastin e ndonjë stresi minimal etj.)

Faza e katërt –testi psikologjik dhe kontrollimi mjekësor

Pas fazës së tretë të intervistës, caktohet numri i kandidatëve që do të përfshijë gjenerata e radhës, pastaj përgatitet lista meritore në bazë të poenëve dhe kandidatët e përzgjedhur i nënshtrohen testit psikologjik dhe kontrollit mjekësor nga komisioni mjekësor i ngritur për këtë qëllim. Këto teste janë të klasifikuara si “kalon ose dështon”. Nëse dështon, aplikacioni juaj do të refuzohet. Nëse kalon, emri i juaj do të futet në listën, nga e cila ne do të zgjedhim grupin tjetër me radhë që do të vijojë shkollën e Policisë të Kosovës në Vushtri. Pozita juaj në listën finale është e bazuar në përbërjen e pikëve (votave), të cilat do të llogariten nga provimi me shkrim dhe ai me gojë.

Faza e pestë - Verifikimi i së kaluarës

Nëse me sukses i keni kryer të katër fazat e procesit, ju do t'i nënshtroheni hetimit (verifikimit) të gjerë të së kaluarës, e cila do të përfshijë verifikimin e të dhënave mbi rastet e mëparshme kriminale, intervistat personale me punëdhënësit tuaj të mëparshëm, si dhe verifikimin e dokumenteve të dorëzuara. Nëse vërtetohet se të dhënat janë të pasakta kjo do të rezultojë me refuzimin e kërkesës për punësim.